



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria – Vlada - Government

Ministria e Shëndetësisë - Ministarstvo zdravstva - Ministry of Health
Divizioni i Prokurimit/Divizia Nabavke/Procurement Division

Prishtine datë, 13.01.2025

Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit i Ministrisë së Shëndetësisë, në mbështetje të nenit 108/A (paragrafi 10.1) të Ligjit për Prokurimin Publik nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, duke u bazuar në nenin 63 të Rregullores për Prokurim Publik të aprovuara nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, duke vendosur sipas kërkesës për ri-shqyrtim të datës 06.01.2025, të parashtruar nga OE BoteK shpk, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: "Furnizimi, implementimi dhe mirëmbajtja e sistemit Packs dhe RIS të SISH" me nr. prokurimi 206-23-13309-1-1-1, nxjerr:

V E N D I M

1. **Refuzohet**, si e pa bazuar kërkesa për ri-shqyrtim e OE BoteK shpk, e dt. 06.01.2025, lidhur me aktivitetin e prokurimit "Furnizimi, implementimi dhe mirëmbajtja e sistemit Packs dhe RIS të SISH" me nr. prokurimi 206-23-13309-1-1-1, kundër Njoftimit mbi vendimin e AK, të datës 30.12.2024;
2. Mbetet në fuqi, Njoftimi mbi vendimin e AK të datës 30.12.2024;
3. Autoriteti Kontraktues, e konsideron të mbyllur aktivitetin e prokurimit;
4. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe do të publikohet për të gjitha palët në platformën elektronike në adresën: <https://e-prokurimi.rks-gov.net>.

A r s y e t i m

OE BoteK shpk, me datën 06.01.2025, ka parashtruar kërkesë për ri-shqyrtim, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: "Furnizimi, implementimi dhe mirëmbajtja e sistemit Packs dhe RIS të SISH" me nr. prokurimi 206-23-13309-1-1-1. Autoriteti Kontraktues, me datë 13.01.2025, ka shqyrtuar kërkesën në fjalë si më poshtë:

Dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga AK sipas OE ankues:

Neni 7 i LPP Nr. 04/L-042 Barazia në Trajtim / Jo-Diskriminimi
Neni 59 i LPP Nr. 04/L-042 Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahasimi i Tenderëve
Pika 40 e RRPP-së Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahasimi i Tenderëve

Pretendimet ankimore te OE ankues:

Përmes kësaj Kërkese për Rishqyrtim atakojmë vendimin tuaj të datës 30.12.2024 për anulim të aktivitetit të prokurimit.

Në vendimin e OSHP-së, datë 15.10.2024, paneli shqyrtues iu obligon që të anuloni Njoftimin mbi vendimin e Autoriteti kontraktues, vendimi i datës 18.07.2024 dhe lëndën ta ktheni në rivlerësim. Ndërsa ju si AK, nuk keni vepruar sipas vendimit të OSHP-së, duke rivlerësuar vetëm ofertën e njërit prej OE pjesëmarrës, dhe jo edhe të OE të tjerë, përfshi dhe ofertën tonë.

Me këtë veprim tuajin, ju keni bërë shkelje të LPP-së, saktësisht Nenit 7 i LPP Nr. 04/L-042 Barazia në Trajtim / Jo-Diskriminimi, duke diskriminuar OE, me mos rivlerësim të ofertave, sipas vendimit të OSHP-së.

Sa për sqarim: vendimi i lartëcekur i OSHP-së nuk kufizon rivlerësimin e ofertës të vetëm një OE, mirëpo kërkon nga ju si AK që të gjithë lëndën ta ktheni në rivlerësim, cit: "Rrjedhimisht Paneli Shqyrtues ka vendosur lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "Furnizimi, implementimi dhe mirembajtja e sistemit Packs dhe RIS te SISH" me nr. të prokurimit: "206-23-13309-1-1-1", të anulohet njoftimi për anulimin e aktivitetit të prokurimit, dhe lënda të kthehet në rivlerësim."

Për më tepër, LPP dhe rregulloret në fuqi, specifikisht përcaktojnë që: "Formulari B58 duhet të përmbajë vendimin mbi rezultatin e aktivitetit të prokurimit dhe letrat standarde përkatëse për Tenderuesit me arsyetimet e nevojshme."

Pra, për secilin vendim të AK për aktivitetin e prokurimit (anulim ose dhënie të kontratës), ju si

AK, pas vlerësimit/rivlerësimit, duhet gjithsesi që të njoftoni secilin OE pjesëmarrës përmes Letrave standarde. E në vendimin tuaj të datës 30.12.2024, ju nga 5 OE/GOE pjesëmarrës, keni publikuar Letrën Standarde për vetëm njërin nga ta.

Poashtu, dyshuese është dhe fakti i kohës së publikimit të vendimit tuaj, me datë 30.12.2024, vetëm një ditë para fillimit të pushimeve të fundvitit, cka penalizon palët e interesuara që të ankimojnë vendimin tuaj.

Ne dhe njëherë konfirmojmë se oferta e konzorciumit tonë, përveq se ofertë me cmimin më të ulët, është plotësisht e përgjegjshme administrativisht dhe teknikisht. Këtë e kemi faktuar disa herë me prova materiale në procedurat e mëparshme të ankimit për këtë aktivitet të prokurimit.

Prandaj, bazuar në këto që u thanë më lartë, kërkojmë nga ju si Autoritet Kontraktues që:

1. Të pranoni si të bazuar Kërkesën tonë për Rishqyrtim
2. Të anuloni Njoftimin mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues, të datës 30.12.2024
3. Lëndën ta ktheni në rivlerësim.

8. Dëmet materiale

Përshkruaj mënyrën se si shkelja e supozuar ka shkaktuar ose kërcënohet t'iu shkaktojë dëme materiale, ne rast se përfshini pretendime për kompensim.

Humbja e fitimit të parashikuar nga kontrata.

Përgjigjet e Autoritetit Kontraktues ne lidhje me pretendimet ankimore:

Pretendimet e juaja ankimore janë te pa bazuara, duke marre parasysh se AK-MSH ka vepruar ne harmoni me vendimin e OSHP-se nr. 2024-0701, sipas te cilit oferta juaj eshte diskualifikuar si e papergjegjshme, lidhur me mosplotësimin e kërkesave të kapacitetit teknik dhe/ose profesional të NJT / Dosjes së tenderit – Referoju paragrafit 1 te vendimit te OSHP-se.

Paneli shqyrtues pas administrimit dhe vlerësimit të provave, konstatimit të plotë të gjendjes faktike, duke u mbështetur në LPP si ligj material të zbatueshëm, pas shqyrtimit të pretendimeve ankimore, duke marrë parasysh të gjitha shkresat e lëndës dhe rekomandimet e ekspertit shqyrtues, ka gjetur se ankesat e Operatorve Ekonomik "Virtuo O.P." dhe OE "Botek shpk"- te aproohen si pjesërisht të bazuara, mirpo nga te gjeturat ne procedur, dhe siç jane te pershkruara ne raportin e ekspertit shqyrtues oferta/tenderi i tij/sajë janë të papërgjegjshme lidhur me mosplotësimin e kërkesave të kapacitetit teknik dhe/ose profesional të dosjes së tenderit.

Bazuar ne konstatimet e vendimit te OSHP-se nr. 2024-0701, eshte mbeshtetur vetem ankesa e ofertes NOVUS SH.P.K. ndersa oferta juaj dhe e OE te tjere eshte diskualifikuar, andaj edhe ne si AK-MSh me te drejte nuk e kemi shqyrtuar gjate rivleresimit dhe e konsiderojme oferte te papergjegjshme dhe pa interes juridiko material ne kete aktivitet.

Zyrtari Përgjegjës i prokurimit bazuar ne ato që u thane më lart ka vendosur si ne dispozitiv.

Këshilla juridike:

Kundër këtij vendimi, ankuesi mund të paraqesë ankesë pranë OSHP-së. Ankesa prane OSHP-se duhet te dorezohet brenda 10 (dhjete) diteve pas pranimit te ketij vendimi.



Berat Marmullaku

Zyrtari përgjegjës i Prokurimit